



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORIA E STANDARDEVE TË FLUTURIMIT

Nr. 2250 prot.

Tiranë, më 23.9.2024

VENDIM

Nr. 103, datë 23.9.2024

PËR

**PËR ZBATIMIN E RREGULLAVE NGA OPERATORËT AJRORË PËR URDHRA
E INTERCEPTIMIT**

Në mbështetje të Nenit 24, pika (1), të Ligjit Nr. 53/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”, dhe në zbatim të Ligjit Nr. 133/2014 Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin në lidhje me një amendament të Konventës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar (neni 3 bis), të nënshkruar në Montreal më 10 Maj 1984 dhe të pikës SERA.11015 të Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 42, datë 27.3.2023, Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror” si dhe të Urdhrit të Ministrit Nr. 80, datë 30.6.2023 “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore”,

V E N D O S A:

1. Shoqëria ajrore Air Albania shpk duhet të sigurohet që cdo pilot në komandën e avionëve në pronësi ose të operuar nga shoqëria Air Albania, që kryen fluturime ndërkombëtare, duhet të njihet me rregullat e zbatueshme të interceptimit të vendeve ku kalon gjatë operimit dhe në rast urdhri interceptimi nga shtetet e tjera, të zbatojë ato rregulla.
2. Për të siguruar përputhshmërinë me kërkesën për procedurat dhe rregullat administrative të interceptimit, parashikimet përkatëse duhet të përfshihen në Manualin e Operimit të shoqërisë sipas kërkesave ORO.MLR.100.
3. Ngarkohet Drejtoria e Standardeve të Fluturimit, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Drejtoria e Standardeve të Fluturimit të marrë masa për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Aviacionit Civil.

DREJTOR EKZEKUTIV

Maksim Et'hemaj

